



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

FJALORTH

Konceptet kyçe në fushën e studimeve gjinore

Autorësia:

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, gusht 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, memorizohet apo përcillet në asnjë formë e me asnjë mjet elektronik, mekanik, me anë të fotokopjes, në disk apo në mënyra të tjera pa miratimin paraprak nga QKSGj.

Përgjegjësia:

Ky fjalorth është përpiluar me mbështetje Financiare të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) në kuadër të projektit "HumanRightivism" të zbaruar nga Community Development Fund - CDF. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e QKSGj-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të CDF.

FJALORTH

Konceptet kyçe në fushën e studimeve gjinore

Feminizmi/at – Ideologji dhe lëvizje politike e cila angazhohet në barazinë ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore mes grave, burrave dhe gjinive jo binare dhe arritjen e drejtësisë shoqërore. Besimi në barazinë dhe vlerësimin e drejtë dhe të barabartë të gjinive. Çati e lëvizjeve të cilat angazhohen për barazi gjinore dhe drejtësi shoqërore. Ekzistojnë forma të ndryshme dhe rryma të ndryshme brenda feminizmit duke përfshirë feminizmin socialist, progresiv, ndërthurës, radikal, anti-koloniaist etj; të cilat përcaktojnë agjenda të ndryshme dhe prioritete specifike brenda konceptit çati - Feminizëm.

Megjithëse çështjet që adreson feminizmi mund të ndryshojnë për shoqëri dhe kulturë të ndryshme, ato mbesin të lidhura ngushtë me filozofinë themelore të Feminizmit e që është arritja e barazisë gjinore dhe drejtësisë shoqërore në çdo sferë të jetës.

Patriarkalizmi - Fjalë për fjalë do të thotë “sundim i babait”. Është një sistem shoqëror, politik dhe ekonomik në të cilin burrat janë bartës të pushtetit dhe mbizotërojnë në rolet e udhëheqjes

në të gjitha strukturat politike, ekonomike, shoqërore e kulturore dhe të kontrollit të pronës. Patriarkalizmi dhe patriarkati si sistem ndërtohen mbi ide fallocentrike të cilat devalvojnë gjithëçka që lidhet me femëroren, duke lartësuar çdo atribut që asocion me “mashkulloren”, duke iu dhënë pushtet burrave mbi gratë, trupat e tyre dhe agjensinë e tyre.

Patriarkalizmi shoqërohet me një sërë idesh dhe ideologji që vepron për të shpjeguar dhe justifikuar këtë dominim dhe ia atribuon dallimeve të natyrshme të natyrshme midis burrave dhe grave, të cilat nuk kanë mbështetje shkencore. Historikisht, patriarkalizmi është shfaqur në organizimin shoqëror, ligjor, politik, fetar dhe ekonomik të një sërë kulturash të ndryshme.

Seksi - Seksi i referohet karakteristikave biologjike të femrave, meshkujve dhe interseks. Seksi përcaktohet në lindje dhe definohet në bazë të karakteristikave fiziologjike të së posalindurit/ës, përfshirë këtu organin gjenital.

Interseks - Janë individët e lindur me karakteristikat biologjike duke përfshirë modelet kromozome,

gonadet ose organet gjenitale që nuk përshtaten me nocionet tipike binare trupit femëror ose mashkullor.

Identiteti gjinor - Identiteti gjinor përcaktohet si vetë-identifikimi me të qenurit grua, burrë, trans/e apo jo-binar. Ky koncept është i lidhur ngushtë me të kuptuarit e rolit gjinor, i cili përcaktohet si manifestim i jashtëm i personalitetit që e karakterizon ndonjërin nga gjinitë. Identiteti gjinor është proces i shoqërizimit dhe vjen si rezultat i një mori të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët e përcaktojnë atë se çka do të thotë të jeshë “burrë”, “grua” etj. Identiteti gjinor manifestohet me sjellje, pamje dhe përjetimin subjektiv të personave. Identiteti gjinor është koncept i ndryshueshëm nga shoqëria në shoqëri dhe nga koha.

Gjinia – Gjinia është pjesë e identitetit të personave e cila historikisht është lidhur ngushtë me seksin. Seksit femëror dhe atij mashkullor iu janë veshur përgjatë historisë edhe tipare dhe narrativa të cilat i kanë përshkruar ato, me qëllim të ndarjes së roleve në organizimin e jetës shoqërore, ekonomike dhe politike.

Gjinia është krijesë shoqërore e cila i referohet atributëve shoqërore që mësohen ose fitohen gjatë shoqërizimit. Si koncept fluid, gjinia si e tillë ajo nuk është fikse apo e dhënë nga natyra por fitohet dhe mësohet në bazë të kontekstit ku individi jeton. Rrjedhimisht, të kuptuarit e gjinisë është i ndryshëm dhe kushtëzohet nga konteksti kohor, gjeografik, historia, politika dhe nga faktorë të ndryshëm të cilët përcaktojnë rolet shoqërore dhe të kuptuarit ndaj gjinisë.

Një kontribut të madh në dekonstruktimin e gjinisë e ka luajtur lëvizja feministe dhe LGBTI+. Gjinia si kategori është objekt studimi i epistemologjisë feministe dhe dekonstruktimit nga lëvizja feministe. Gjinia, varësisht nga konteksti, është shtypëse dhe privilegjuese. Në shoqëritë patriarkale, gjinia e grave është pika përmes së cilës ato diskriminohen dhe përjashtohen sistematikisht nga fusha të caktuara. Ndërsa për burrat, gjinia iu lejon kontrollin dhe qasjen në burime, vendimarrje, jetë politike dhe të lirë nga dhuna me bazë gjinore.

Performativiteti i gjinisë - Performativiteti i gjinisë është term i përdorur për herë të parë nga filozofja feministe Judith Butler. Ajo argumenton se gjinia nuk ka esencë apo natyrë biologjike por është rezultat i mënyrës se si sillet dhe e performon gjininë.

Gjinia cis -Term i përdorur për të përshkruar një person identiteti gjinor i të cilit përputhet me seksin që i është caktuar në lindje.

Fluiditeti gjinor - Mos identifikimi me një gjini të vetme, fikse.

Gjini jo-binare - Është term ombrellë për identitetet gjinore që janë jashtë binarit gjinor grua-burrë. Personat me gjini jo-binare mund të mos identifikohen me asnjërën gjini, me gjini tjetër nga ajo çka iu është dhënë nga lindja, me të dy gjinitë, pa gjini ose të kenë gjini fluide.

Transgjinor/e - Ky term përfshin personat të cilët nuk identifikohen me gjininë e caktuar në lindje. Transgjinorët/et manifestojnë gjininë e tyre përmes mënyrës se si ndihen, akteve dhe sjelljeve të cilat janë tipike për një të gjini, veshjeve, ndërhyrjeve

kirurgjikale në organet gjenitale të jashtme e të brendshme dhe ndërhyrjeve tjera në fizik.

Rolet gjinore - Janë sjellje të mësuar në një shoqëri ose grup të caktuar që kushtëzojnë aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë që perceptohen si mashkullore dhe femërore. Rolet gjinore janë produkt i historisë dhe faktorëve të tjerë politik, religjioz, zhvillimi i ekonomisë, mjedisi gjeografik dhe etnia, të cilat edhe e kushtëzojnë ndryshimin e roleve gjinore.

Burrat dhe gratë luajnë role të shumta në shoqëri. Në patriarkalitet, rolet gjinore të grave identifikohen si role riprodhuese, vazhduese dhe mirëmbajtëse të jetës dhe organizimit të jetës në komunitet ndërsa burrat ndërlidhen me role të jetës publike, prodhimi i dijes, politika dhe angazhime jashtë hapësirës private.

Stereotipet gjinore - një grup i përgjithësuar i tipareve dhe karakteristikave që i atribuohen një gjinie i cili krijon pritshmëri të arbitrare që ato janë përfaqësuese të të gjithë personave që mund t'i përkasin një identiteti dhe që sjelljet e tyre do të jenë në përputhje me këto tipare.

Norma gjinore - Standardet dhe pritjet të cilave burrat dhe gratë në përgjithësi i përshtaten e të cilat janë brenda një game të gjerë vlerash të cilat e definojnë një shoqëri, kulturë a grup të caktuar në periudhë dhe kontekst gjeografik të caktuar.

Seksualiteti - Aspekt themelor i fiziologjisë njerëzore. Ai përfshin njohuritë, besimet, qëndrimet dhe sjelljet seksuale, duke përfshirë identitetet dhe rolet gjinore, orientimin dhe riprodhimin seksual. Seksualiteti përjetohet dhe shprehet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke përfshirë mendimet, fantazitë, dëshirat, besimet, qëndrimet, vlerat, sjelljet, praktikat, rolet dhe marrëdhëniet. Seksualiteti nuk përjetohet gjithmonë ose shprehet hapur dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndikohet nga ndërveprimi i faktorëve fizikë, psikologjikë, socialë, ekonomikë, politikë, kulturorë, etikë, ligjorë, historikë, fetarë dhe shpirtërorë

Orientimi seksual - Term i përdorur për të përshkruar nëse një person ndjen dëshirë seksuale për njerëzit e gjinisë së kundërt, të së njëjtës gjini ose të dyja gjinitë. Njerëzit që ndjejnë dëshirë seksuale

për personat e gjinisë tjetër janë heteroseksualë. Njerëzit që ndjejnë dëshirë seksuale për njerëzit e së njëjtës gjini janë homoseksualë. Njerëzit që tërhiqen nga të dyja gjinitë janë biseksualë.

Heteroseksualiteti - Personat për të cilët orientimi i tyre seksual u drejtohet ekskluzivisht ose kryesisht personave të seksit tjetër.

Panseksualiteti - I referohet tërheqjes seksuale ose romantike ndaj të tjerëve pavarësisht identitetit të tyre seksual ose gjinor.

Queer - Fjalë e përdorur për t'iu referuar personave lesbike, biseksualë/e, gejë, personave trans/e, panseksualë/e dhe jo-binarë.

Homofobia - Frika nga homoseksualiteti. Një fobi është një frikë joracionale që bie ndesh me normat kulturore, por homofobia përdoret më së shpeshti për të përcaktuar një urrejtje paragjyquese ndaj homoseksualitetit të krahasueshme me racizmin. Homofobia mund dhe është institucionalizuar shpesh në ligjet, politikat dhe shpalljet e kishës dhe shtetit kundër homoseksualëve. Ajo gjithashtu manifestohet tek individët, ku efektet

e saj mund të shkojnë nga abuzimi verbal deri në dhunimin e homoseksualëve dhe madje edhe vrasjen. Një nga manifestimet e tij më fatkeqe është tek homoseksualët të cilët janë bindur nga shoqëria se ndjenjat dhe dëshirat e tyre janë monstroze dhe meritojnë ndëshkim.

Heteronormativiteti - Rolet gjinore janë sjellje të mësuara në një shoqëri/bashkësi të caktuar, ose grup tjetër të veçantë, që kushtëzojnë aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë që perceptohen si meshkuj dhe femra. Rolet gjinore ndikohen nga mosha, klasa, raca, përkatësia etnike, feja dhe mjedisi gjeografik, ekonomik dhe politik. Ndryshimet në rolet gjinore shpesh ndodhin në përgjigje të ndryshimit të rrethanave ekonomike, natyrore ose politike, përfshirë përpjekjet për zhvillim. Burrat dhe gratë luajnë role të shumta në shoqëri. Rolet gjinore të grave mund të identifikohen si role riprodhuese, produktive dhe menaxhuese të komunitetit, ndërsa burrat kategorizohen si politikë produktive ose të komunitetit. Burrat janë në gjendje të përqëndrohen në një rol të veçantë produktiv dhe të luajnë rolet e tyre të shumëfishta

radhazi. Gratë, në kontrast me burrat, duhet të luajnë rolet e tyre njëkohësisht, dhe të balancojnë pretendimet konkurruese në kohë për secilën prej tyre.

Fallocentrizmi - Termi i referohet organizimit kulturor dhe shoqëror të botës të nxitur nga patriarkati.

Maskuliniteti hegjemonist - Ide e ndërtuar shoqërisht dhe historikisht se çfarë duhet të jenë burrat, në një mënyrë një strukturë që lidh fuqinë me maskulinitetin.

Hierarki - Sistem vlerash i renditjes së roleve të njerëzve si superiorë ndaj të tjerëve në një rend zbritës ndaj atyre që konsiderohen inferior.

Privilegj - Një e drejtë, avantazh i dhënë ose i disponueshëm vetëm për një person ose grup njerëzish.

Diskriminimi gjinor - Nënkupton paragjykimin, trajtimin ndryshe, kufizimin apo mohimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër pikërisht për shkak të gjinisë

së personit. Diskriminimi gjinor nënkupton të gjitha normat dhe praktikat e dëmshme të cilat bazohen mbi idetë e ndërtruara rreth rolit dhe pozitës që ndonjëra gjini e ka në kohë dhe vend të caktuar e që pengon në jetësimin e të drejtave dhe lirive të plota njerëzore. Diskriminimi gjinor vjen si rezultat i raporteve të pushtetit mes gjinive dhe si i tillë ka tendencë t'iu ndodhë grave dhe personave të komunitetit LGBTI+.

Diskriminimi sistemik - Shkaktohet nga politikat dhe praktikat mbi të cilat funksionojnë institucionet e që rezultojnë në qasje përjashtuese të grupeve të marginalizuara ose të paprivileguara socio-ekonomike siç janë gratë, personat LGBTI+, pakicat etnike ose/dhe racore. Diskriminimi sistemik vjen si pasojë e mos-vlerësimit të drejtë të të gjitha identiteteve dhe praktikave "neutrale" të cilat përfaqësojnë interesat e një grupi të vogël të privilegjuar.

Diskriminim i shumëfishtë - Çdo kombinim i formave të diskriminimit kundër personave për shkak të gjinisë, racës, etnisë fesë ose besimit, paaftësisë, moshës, orientimit seksual, identitetit

gjinor ose karakteristikave të tjera. Një grua e cila është rome ka tendencë të jetë dukshëm shumëfish e diskriminuar në krahasim me një grua shqiptare. Gjithashtu, një burrë gej, egjiptian, i zonës rurale, ka gjasa të jetë shumëfish më shumë i diskriminuar sesa një burrë gej në zonë urbane.

Dhuna me bazë gjinore - Dhuna me bazë gjinore është një fenomen i cili shpërfaqë pabarazinë e thellë gjinore dhe vazhdon të jetë një nga shkeljet më të dukshme të të drejtave të njeriut brenda të gjitha shoqërive. Dhuna me bazë gjinore është dhuna e drejtuar kundër një personi për shkak të gjinisë së tij. Në shumicën dërrmuese të rasteve, vajzat, gratë dhe transgjinorët/et janë viktimat e dhunës me bazë gjinore. Dhuna me bazë gjinore nënvijëzon problemin kyç në shoqëritë patriarkale e që është shpërndarja e pabarabartë e pushtetit, për rrjedhojë akumulimin e tij në duart e burrave.

Feminizimi i vrafërisë - Nënkupton që gratë kanë më shumë tendencë se burrat të jenë të varfëra dhe që varfëria e tyre është dukshëm më e thellë në krahasim me burrat. Për shkak të pabarazisë historike gjinore, gratë kanë shumë

më pak tendenca të kanë qasje në kapital, në punë dhe në të mira në krahasim me burrat. Në masë të gjerë, puna e grave hynë në domenin e punëve të papaguara, çka shkakton një situatë ku gratë e kanë dukshëm më vështirë të sigurojnë të ardhura apo dhe të kenë kapital si pasojë e praktikave patrilineare të bartjes së trashëgimisë nga burrat tek burrat. Në mbarë botën, gratë fitojnë mesatarisht pak më shumë se 50 përqind të asaj që fitojnë burrat. Kjo sugjeron që ndërhyrjet për të adresuar varfërinë e grave kërkojnë politika të ndjeshme gjinore.

Moshizmi - Paragjykimi ndaj një personi ose njerëzve për shkak të moshës së tyre. Qëndrimet, perceptimet, veprimet ose edhe qasjet institucionale të cilat rezultojnë si diskriminuese ndaj një personi ose grupi për shkak të moshës së tyre. Moshizmi është evident sidomos në tregun e punës dhe në kushtet e konsumerizmit ku moshave më të vjetra u vihen ngarkesa pezhorative.

Moshizmi është problem edhe në lëvizjet shoqërore dhe sfidë edhe për lëvizjen feministe. Konfliktet ndër-gjenerata janë evidente edhe në

lëvizjen feministe. Gratë e reja në lëvizjen feministe mund të mos merren seriozisht dhe kontributi i tyre të mos njihet për shkak të “përvojës së vogël” në lëvizje. Në anën tjetër, përvoja e akumuluar nga feministet më të vjetra, ka mundësi të përjashtohet nga brezat e rinj të aktivisteve për shkak të paragjyqimeve që janë të tejkaluara, paraqet problem të moshizmit -diskriminimit me bazë moshe.

Racizmi - Paragjykimet ose diskriminimi janë të rrënjosura në idenë se raca ose ngjyra e lëkurës është një përcaktues i tipareve ose aftësive njerëzore dhe se dallimet në ngjyrën e lëkurës përcaktojnë ose pasqyrojnë inferioritetin dhe superioritetin e ndonjë grupi apo personi. Racizmi dhe diskriminimi racor mund të jenë të hapura, për shembull, në formën e ligjeve dhe politikave diskriminuese. Më shpesh, racizmi është ngulitur thellë në institucionet shoqërore dhe politike dhe në sistemet e besimit në mënyrë të tërthortë ose të maskuar.

Femicidi - Vrasjet e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë së tyre. Vrasja e grave lidhet ngushtë me

pabarazinë gjinore dhe shpërfilljen institucionale të të drejtave të grave dhe ideve që lidhen me trupin e gruas. Në shoqëri patriarkale trupi i grave shihet më pak i vlefshëm se sa ai i burrave dhe rrjedhimisht më lehtë i dhunueshëm e që rezulton edhe në vrasjen e tyre.

Dikotomia - Fjalë për fjalë nënkupton një “prerje në dysh”. I referohet një ndarjeje të një uniteti ose sistemi në dy kategori reciprokisht ekskluzive, të kundërta. Dikotomia është një mënyrë e të menduarit që sheh gjithçka në terma thjesht “ose”, për shembull mashkull/femër, private/publike, duke e thjeshtëzuar kompleksitetin e së ndryshmes dhe duke i vendosur përballë njëra-tjetrës kategoritë.

Klasa - Është kategori socio-ekonomike e cila përcaktohet nga të ardhurat, pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme e statusin ekonomik familjar. Klasa është një nga përcaktuesit e pabarazive shoqërore dhe e përcakton një sistem ekonomik dhe politik të padrejtë në të cilin nevojat dhe kërkesat e një grupi të madh nuk plotësohen, teksa pasuria gjendet në një numër të vogël të personave.

Puna riprodhuese - Përfshin të gjitha punët që lidhen me lindjen dhe riprodhimin e fuqisë punëtore aktuale dhe të ardhshme. Ai përfshin lindjen dhe edukimin e fëmijëve por nuk kufizohet me to. Puna riprodhuese njihet edhe si “riprodhim shoqëror” i cili i referohet të gjitha aktiviteteve të cilat sigurojnë vijueshmërinë e jetës dhe sigurimin e forcës punëtore e që përfshijnë kujdesin ndaj fëmijëve, përgatitjen e ushqimit, kujdesin për të sëmurët, shoqërimin e të rinjve, vëmendjen ndaj aktiviteteve rituale dhe kulturore përmes të cilave transmetohet etika e punës e shoqërisë, ndarjen dhe mbështetjen e komunitetit e cila është thelbësore për ekonomiën. Puna riprodhuese kalon pa u paguar dhe i atribuohet grave në saje të aftësisë për të lindur fëmijë. Për pasojë, gratë mbesin dukshëm më pak të angazhuara në tregun e punës së paguar, duke i kontribuar asaj dhe rritjes ekonomike të vazhdueshme.

Puna prodhuese - Kjo është punë që prodhon mallra dhe shërbime për këmbim në treg.

Puna e kujdesit - Puna e kujdesit përfshin kujdesin e ofruar për fëmijët, të moshuarit, të sëmurët dhe

personat me aftësi të kufizuara në institucionet e kujdesit ose në shtëpinë e personit që kërkon kujdes. Politikat e kujdesit dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit janë të lidhura në thelb me arritjen e barazisë midis grave dhe burrave. Mungesa e shërbimeve të përballueshme, të arritshme dhe me cilësi të lartë të kujdesit dhe fakti që puna e kujdesit nuk ndahet në mënyrë të barabartë midis grave dhe burrave kanë një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në aftësinë e grave për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike.

Ndarja gjinore e punës - Ndarja e punës "gjinore [ose "seksuale"] i referohet ndarjes së punëve me bazë gjinore e që i atribuon burrave dhe grave punë të caktuara të cilat rëndom pritete të kryhen prej tyre. Ndarja gjinore e punës është produkt i zhvillimit të mjeteve të punës të cilat kanë ndikuar në zhvillim të padrejtë të mënyrës se si burrat e gratë i performojnë detyrat në ekonominë familjare dhe jashtë saj. Nga ana tjetër, aftësia femërore për të lindur, ka çuar që grave t'iu atribohen punët riprodhuese dhe të

kujdesit, ndërsa burrave ato prodhuese. Ndarja gjinore e punës ka rezultuar në diskriminim të vazhdueshëm të grave e që ka ndikuar në statusin e tyre ekonomik, shoqëror e politik për shkak të akumulimit të kapitalit në duar të burrave dhe të mundësisë të punës për pagë.

Hendeku gjinor në paga - I referohet praktikave ku gratë fitojnë më pak në krahasim me burrat për punë të njëjtë. Gjithashtu, sistemimin e grave në pozita të cilat paguhen më pak në krahasim me burrat.

Ekonomia jo-formale - Sektor ekonomik në të cilat mallrat dhe shërbimet blihen dhe shiten jashtë tregut formal, pa rregullim ose taksim shtetëror dhe në disa raste, bazuar në shkëmbime jo-monetare. Tregu jo-formal i punës është një nga sektorët më të rrezikshëm për punëtorët/et pasiqë ata/o nuk figurojnë në të dhënat zyrtare dhe për pasojë kanë qasje të kufizuar në shërbimet institucionale duke rezultuar në pasiguri të lartë. Për shkak të diskriminimit sistematik që paraqet barrierë për pjesëmarrjen e grave në tregun formal të punës, gratë janë të përqendruara në

ekonominë joformale në shumë vende. Ekonomia joformale është sektori ekonomik me rritjen më të shpejtë në shumë vende në zhvillim.

Puna emocionale - Puna emocionale i referohet procesit me të cilin punëtorët pritet të menaxhojnë ndjenjat e tyre në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara nga ana e punëdhënësit. Puna emocionale ndodhë edhe në sferën private dhe atë të vendit të punës në treg dhe si i tillë ka natyrë të gjinizuar. Ajo përfshin pritjet dhe veprimet të cilat kryhen sidomos nga gratë e që përfshin aftësinë për t'i përmbajtur emocionet personale dhe preokupimin me vetën, kujdesin dhe vëmendjen e shtuar ndaj ambientit të jashtëm e që në masë të madhe lidhet me idetë rreth "natyrës femërore".

Seksizmi - Sistem i ideve, veprimeve ose/dhe qëndrimeve të cilat diskriminojnë persona të caktuar pikërisht për shkak të gjinisë së tyre. Seksizmi vjen si pasojë e raporteve të pushtetit që ndërtohen mes gjinive dhe rezulton në trajtim të padrejtë të gjinive të paprivileguara nga të privilegjuarit që zakonisht janë burra, heteroseksualë, të bardhë, të pasur.

Mizogjinia - urrejtje, përbuzje ndaj grave ose besim që burrat janë në parim më të aftë dhe më të mirë se sa gratë.

Grupet e paprivileguara - Grupet e personave që përjetojnë një rrezik më të lartë të varfërisë, përjashtimit social, diskriminimit dhe dhunës sesa popullata e përgjithshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, gratë, personat LGBTI+, pakicat etnike, emigrantët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe personat që jetojnë në vise rurale.

Dhuna ekonomike - Çdo veprim ose sjellje që shkakton dëm ekonomik mbi një individ. Dhuna ekonomike mund të marrë formën e mohimit ose kufizimit në burimet financiare, të arsimit ose tregut të punës, mos-njohja e punës së kujdesit, mosrespektimit të përgjegjësive ekonomike siç është alimentacioni ose edhe dëmtim i pronës.

Dhënia e pëlqimit - Të japësh pëlqim do të thotë ta miratosh atë që mund të ndodhë kur hynë në një raport me një palë tjetër. Dhënia e pëlqimit është fundamentale në çdo raport dhe

vjen si nevojë sidomos në rastet e marrëdhënieve seksuale dhe e njohjes së autonomisë trupit dhe aspekte tjera personale të tjetrit/ës.

Pëlqimi mund të jetë verbal dhe joverbal. Jo çdo herë mos-dhënia e pëlqimit mund të vijë në formë të prerë, kjo për shkak të pozitës së pafavorshme në të cilën mund të gjenden palët gjatë një raporti të natyrës seksuale. Gjithashtu, pamja, veshja, statusi, vendodhja apo edhe raporti paraprak, nuk do të thonë asesi dhënie e pëlqimit.

Shëndeti seksual - Gjendja e mirëqenies fizike, emocionale, mendore dhe shoqërore që ndër-lidhet me seksualitetin. Shëndeti seksual nuk është thjesht mungesa e ndonjë semundjeje, mosfunksionimit ose dobësisë. Ai përfshin mirëqenien dhe konsiderimin e vazhdueshëm të seksualitetit të një personi me respekt, pa trysni apo paragjykim dhe mundësinë për të pasur përvoja seksuale të këndshme dhe të sigurta, pa detyrim, diskriminim dhe dhunë. Që të arrihet dhe mirëmbahet shëndeti seksual, të drejtat seksuale të të gjithë personave duhet të respektohen, mbrohen dhe përmbushen.

Të drejtat riprodhuese - Të drejtat riprodhuese përfshijnë të drejta të caktuara të njeriut të njohura tashmë në përmes ligjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale. Këto të drejta njohin dhe mbrojnë të drejtën themelore të individëve dhe çifteve heteroseksuale dhe homoseksuale për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi për t'u riprodhuar. Të drejtat riprodhuese përfshijnë edhe të drejtën në informacion, shërbimet për shëndetin riprodhues dhe mjetet e disponueshme për t'u kujdesur për shëndetin riprodhues. Të drejtat riprodhuese janë sidomos të rëndësishme për trupin femëror dhe për të sanksionuar të drejtën e çdo femre për të marrë lirshëm vendime mbi riprodhimin.

Planifikimi familjar - Nënkupton kontrollimin dhe planifikimin e numrit të fëmijëve të cilët individët dhe çiftet duan të kenë, periudhën ndërmjet fëmijëve dhe aplikimin e metodave mbrojtëse për kontrollin e numrit të fëmijëve.

Leja e lehonisë - Është pushim me pagesë që u lejon punëtoreve kohë për shtatzëni, lindje, shërim pas lindjes, birësim dhe kujdes për fëmijët.

Leja atërore - Leje nga puna që babai i një fëmije mund të marrë në kohën e lindjes, ose në sasi të caktuara kohore në çdo vit ose periudhë vitesh.

Leja prindërore - Leje nga puna e cila i ipet secilit prind për t'u kujdesur për fëmijën e tyre të lindur apo të adoptuar.

Dhuna ndaj grave - “Dhuna ndaj grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe njëna format e diskriminimit ndaj grave dhe përfshin një sërë të formave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave e që përfshijnë por nuk reduktohen në dhunë fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike, emocionale, përfshirë kërcënimet për përdorimin e dhunës, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qofshin ato në jetën publike ose në jetën private. Dhuna me me bazë gjinore ndaj grave iu ndodhë atyre pikërisht për faktin se ato janë gra.

Ekspluatimi seksual - I referohet çdo abuzimi ose tentative të abuzimit të pushtetit, besimit apo dhe cenueshmërisë së individit për qëllime seksuale.

Ngacmimi seksual - nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale, apo

fizike të natyrës seksuale dhe/apo psikologjike, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fytes. Ngacmimi seksual i përfshinë por nuk kufizohet në përkufizimet e përcaktuara në këtë dispozitë. Ngacmimi seksual paraqet diskriminim gjinor.

Gjymtimi gjenital - Gjymtimi gjenital femëror i referohet të gjitha procedurave që përfshijnë heqjen e pjesshme ose të plotë të organeve gjenitale të jashtme femërore ose dëmtime të tjera të organeve gjenitale femërore për arsye jo mjekësore. Praktika e gjymtimit gjenital ka karakter kulturor dhe patriarkal i cili bëhet me qëllim që vajzave dhe grave t'iu mohohet ndjenja e kënaqësisë gjatë marrëdhënieve seksuale. Gjymtimi gjenital femëror njihet ndër kombëtarisht si shkelje e të drejtave të njeriut të vajzave dhe grave. Ajo pasqyron pabarazinë e rrënjosur thellë midis gjinive dhe përbën një formë ekstreme të diskriminimit ndaj grave. Gjymtimi gjenital kryhet shpesh në moshë të hershme dhe paraqet edhe shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Sulmi seksual - Çdo akt i natyrës seksuale i kryer ndaj një personi i cili ndodhë pa pëlqim edhe nëse personi nuk tregon shenja të rezistencës, e cila mund të kushtëzohet nga faktorë të tjerë.

Përdhunimi - përfshin penetrimin vaginal, anal ose oral i cili ka natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër dhe ndodhë pa pëlqimin e saj/tij. Penetrimi kryhet me forcë, kërcnim ose detyrim dhe ndodhë në kushte të frikësimit të një personi nga një person tjetër.

Fajësimi i viktimës - Fajësimi i viktimës është kur një viktimë e një krimi ose ndonjë veprimi të gabuar, siç është përdhunimi, konsiderohet fajtor për dëmin që i ka ndodhur. Gratë shpesh fajësohen dhe turpërohen si viktima në të njëjtën kohë.

Përdhunimi në martesë - Përdhunimi martesor është çdo akt seksual i padëshiruar nga një bashkëshort ose ish-bashkëshort, i kryer pa pëlqimin dhe/ose kundër vullnetit të një personi, të marrë me forcë, ose kërcënim me forcë, kanosje, ose kur një person nuk është në gjendje të japë pëlqimin. Këto

akte seksuale përfshijnë marrëdhënie seksuale, seks anal ose oral, sjellje seksuale të detyruar me individë të tjerë dhe aktivitete të tjera seksuale që konsiderohen nga viktimi si poshtëruese, poshtëruese, të dhimbshme dhe të padëshiruara.

Përdhunimi si mjet lufte - Nënkupton përdhunimin dhe/ose forma të tjera të dhunës seksuale të kryera nga forca persona të involvuar në luftë përgjatë një lufte, konflikti civil apo okupimi ushtarak. Përdhunimi në këto raste përdoret si mjet për të poshtëruar, fituar mbi kundërshtarin.

Vështrim i ngultë mashkullor - Shikim i gjatë/lent mashkullor që i sheh gratë si objekte seksuale.

Esencializmi - Esencializmi është supozimi se njerëzit kanë një “natyrë” fikse e që bashkëndahet të të gjithë anëtarët/et e atij grupi ose kategorie. Esencializmi si qasje supozon se tipare të formuara historikisht dhe si pasojë e procesit të shoqërizimit dhe faktorëve të jashtëm, janë pjesë e biologjisë. P.sh. ideja që grate janë më të kujdesshme ose emocionale për shkak të natyrës së tyre.

Varfëria menstruale - Është mungesa e qasjes në produktet sanitare për shkak të kufizimeve financiare. Varfëria menstruale vjen si pasojë e diskriminimit sistemik që përjetojnë gratë dhe mos-marrjes parasysh së shëndetit menstrual si pjesë të rëndësishme të shëndetit publik.

Barazi gjinore- Nënkupton besimin dhe praktikën e barazisë mes gjinive dhe mos-diskriminimin me bazë gjinore në të gjitha format e organizimit.

Integrimi gjinor - Është procesi i vlerësimit të implikimeve për burrat dhe gratë në çdo veprim të planifikuar, përfshirë legjisllacionin, politikat ose programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Ai është një strategji për t'i bërë interesat dhe eksperiencat e grave si dhe të burrave një pjesë përbërëse të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pabarazia të mos mirëmbahet.

Ndjeshmëria gjinore- Të kuptuarit dhe marrja parasysh e faktorëve shoqërorë dhe kulturorë që

ndikojnë në pozitën e gjinive të caktuara në një shoqëri dhe kontekst të caktuar, përjashtimin dhe diskriminimin me bazë gjinore që ndodhë në sfera të ndryshme të jetës publike dhe private.

Buxhetimi i ndjeshëm gjinor- Është strategji që adreson pabarazitë gjinore në shoqëri përmes investimit në to. Kjo nënkupton futjen e perspektivës hartimin, zbatimin, priorizimin, kanalizimin, monitorimin dhe vlerësimin e parasë publike. Buxhetimi i ndjeshëm i njeh pozitat e ndryshme socio-ekonomike që gjinitë i zënë në shoqëri dhe tenton t'i përmirësojë ato përmes alokimit të buxhetit në fushat ku diskriminimi është i evidentueshëm.

Drejtësia gjinore- Është kusht për arritjen e barazië gjinore. Ajo i njeh pozitat e ndryshme që gjinitë i zënë në shoqëri dhe i targeton ato në forma të rishpërndarjes apo masave afirmative, të domosdoshme për t'i zbutur apo zhdukur pabarazitë dhe padrejtësitë ekzistuese. Drejtësia gjinore e hedh poshtë parimin që “neutraliteti” dhe “trajtimi i barabartë” i të gjitha gjinive i adreson problemet e natyrës gjinore në një kontekst a

shoqëri të caktuar, duke qenë që brenda këtyre shoqërive njëra gjini është dukshëm më e privilegjuar në krahasim me tjetrën. Drejtësia gjinore është fazë e cila përcakton nivelet minimale të mirëqenies së një grupi identitar gjinor nga ku tentohet të zvogëlohet hendeku i pabarazisë.

Masat afirmative - një përpjekje aktive për të përmirësuar mundësitë e punësimit ose arsimimit për anëtarët e grupeve minoritare dhe për gratë. Veprimi afirmativ filloi si një ilaç qeveritar për efektet e diskriminimit të gjatë ndaj grupeve të tilla dhe ka qenë i përbërë nga politika, programe dhe procedura që japin preferenca të kufizuara për minoritetet dhe gratë në punësimin e punës, pranimin në institucionet e arsimit të lartë, dhënien e kontratave qeveritare, dhe përfitime të tjera sociale. Kriteret tipike për veprimin afirmativ janë raca, paaftësia, gjinia, origjina etnike dhe mosha.

Kuota gjinore - Instrumenti pozitiv që synon përsheptimin e arritjes së pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të balancuar gjinor duke përcaktuar

një përqindje të caktuar ose prag të përfaqësimit të njërës gjini në institucione publike dhe struktura tjera përfaqësuese. Kuotat gjinore janë metoda neoliberales të adresimit të pabarazisë gjinore përmes “balancimit” numerik të pjesëmarrjes së gjinive në institucione publike apo edhe private. Kuotat janë shumë të shprehura sidomos në institucionet përfaqësuese të shteteve siç janë parlamentet dhe asamblatë lokale.

Politika identitare - Term i cili përdoret për t’iu referuar përpjekjeve politike dhe studimeve në fushat sociale që e vendosin identitetin në qendër si kategori mbi të cilat duhet kornizuar politikat dhe ideologjitë dhe për të shpjeguar pabarazitë socio-ekonomike. Politika identitare e njeh faktin që përkatësia identitare e përcakton pozitën që një individ ose grup e zë në shoqëri, andaj dhe politikat duhet t’i njohin ato me qëllim të adresimit të tyre. Politikat identitare lidhen ngushtë me lëvizjet shoqërore të gjysmës së dytë të shek. XX, përfshirë këtu lëvizjen e grave, lëvizjen anti-raciste dhe lëvizjen LGBTI+.

Epistemologjia feministe - Rrymë filozofike e cila e shqyrton ndikimin e gjinisë në prodhimin e dijeve. Epistemologjia qendëron raportin prodhues -pozicion -dije. Në këtë linjë, ajo e dekonstrukturon atë që dija është produkt i rrethanave dhe faktorëve ekonomikë, politik, kulturor dhe personal dhe si i tillë paraqet vlerësimet individuale më shumë se sa paraqitje objektive e realitetit. Kjo pasiqë historikisht “dija” e prodhuar i ka lënë jashtë saj përvojat dhe njohuritë e grupeve të caktuara siç janë gratë, duke rezultuar kështu në dije subjektive. Rrjedhimisht, sipas epistemologjisë feministe dijet janë gjithmonë politike dhe fuqia për të prodhuar dije pasqyron dhe mirëmbanë marrëdhëniet shoqërore që ekzistojnë në një shoqëri.

Teoria feministe - Teoria feministe i analizon fenomenet socio-politike brenda një strukture përmes lensit gjinor. Lentet analitike brenda teorive feministe e de-qendërojnë perspektivën mashkullore në vëzhgimin dhe shpjegimin e proceseve socio-politike, duke e vendosur atë edhe në përvojat dhe perspektivat e grave.

Studime gjinore - Fushë e studimeve akademike, zakonisht ndërdisiplinore të cilat analizojnë dinamikat gjinore nga prizma të ndryshëm teorik në nivel politik, ekonomik dhe shoqëror.

Politika e lokacionit - Një perspektivë kërkimore e cila doli nga metodologjia feministe, kryesisht përmes kritikave të grave me ngjyrë në veriun global dhe jugun global, të cilat e konsideruan shumicën e kërkimeve të hershme gjinore si rrjedhim i një perspektive të përgjithshme të bardhë, veriore, të klasës së mesme. Politika e vendndodhjes sugjeron që prejardhjet personale dhe përvojat e studiuesve (të zgjedhur apo të imponuar nga shoqëria) kanë implikime politike dhe teorike që duhet të artikuloohen gjatë gjithë procesit të kërkimit.

Gjinia si variabël shkencore - Sigurimi që përfshirja e gjinisë si një variabël shkencore të jetë kriter për vlerësimin e propozimeve hulumtuese dhe projekteve kërkimore.

Ndërthurja - I referohet natyrës së ndërlidhur të kategorive shoqërore si raca, klasa dhe gjinia dhe

asaj se si këto identitete e përcaktojnë përvojën dhe pozitën që individët apo/dhe grupet e kanë në një kontekst të caktuar. Ndërthurja është qasje e rëndësishme në studimet gjinore dhe lëvizjen feministe e cila mundëson të kuptuarit më të avancuar të ndërlikueshmërisë së dinamikave të pushtetit brenda grupeve dhe individëve dhe atë se si identitetet e ndryshme ndërveprojnë mes vete për ta përcaktuar pozitën socio-ekonomike. Kontributi kryesor i teorisë së ndërthurjes është të kuptuarit që sistemet e ndryshme të shtypjes nuk veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe ato asesi nuk mund të shihen si të ndara nga forma të tjera të shtypjes.

Lëvizje feministe - Lëvizjet me qëllime politike gjinore, të cilat prioritulojnë interesat e grave dhe gjinive tjera të shtypura duke kërkuar transformimin e marrëdhënieve gjinore dhe sistemeve politike që i mbështesin dhe i mirëmbajnë pabarazitë.

Agjencia - Aftësia për të ndërmarrë veprime ose/ dhe vendime individuale. Agjencia është shumë e rëndësishme në lëvizjet politike, kjo për t'i ikur

shndërrimit të individëve në “objekte” fati i së cilave/ëve duhet ndryshuar nga një palë tjetër dhe për t’i trajtuar të ata/o si subjekte dhe agjentë/e të ndryshimit.

Rezistenca Akti i sfidimit të strukturës dominuese dhe pushtetit shtypës. Rezistenca mund të zhvillohet në forma dhe ambiente të ndryshme, duke filluar nga refuzimi apo sfidimi i roleve tradicionale në mënyrë individuale e deri tek organizimi në forma kolektive për kundërshtimin e politikave shtypëse qoftë përmes protestave, marsheve, grevave e bojkoteve. Në thelb, rezistenca është një veprim dinamik, revolucionar ose radikal i përdorur në disa raste pas angazhimit.

Aktivist/e politike - Dikush që shqetësohet për padrejtësitë, pabarazitë dhe/ose mirëqenien e të tjerëve dhe të mirës publike dhe që ndërmerr ose organizon veprime politike me të tjerët dhe çonë përpara kauza dhe alternativa progresive të cilat sigurojnë ndryshime shoqërore, politike dhe ekonomike.

Solidaritet - Nënkupton pëpjekjen për angazhim dhe unifikim për kauzat dhe shqetësimet shoqëror.

Mobilizimi Përfshirja e njerëzve si aktivistë/e politikë përmes organizimit dhe akteve e veprimeve që synojnë të ndikojnë dimensione të ndryshme të organizimit politik dhe kanë objektiva e qëllime të qarta politike. Individët dhe grupet shpesh organizohen për objektiva specifike e padrejtësi dhe ndodhë në kushte të ndërgjegjësimit për padrejtësitë dhe vullnetin për ta ndryshuar status quo-në.

BIBLIOGRAFIA:

Fjalori i Oksfordit:

<https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/>

Udhëzues: Integrimi i perspektivës gjinore në praktikë, Astrida Neimanis, 2002

Mediterranean Institute for Gender Studies, Glossary of Gender-related Terms, 2009

Instituti Evropian për Barazi Gjinore:

<https://eige.europa.eu/thesaurus>

